



BULETIN MUJOR

NËNTOR 2025



PËRMBAJTJA

- Ballkani Perëndimor në fokus: forcimi i kapaciteteve për identifikimin dhe kundërveprimin ndaj kërcënimeve hibride
- Nga reagimi te parandalimi: qasja e re kombëtare për menaxhimin e rrezikut kibernetik
- AKSK vendos fokusin te testimi inteligjent dhe vlerësimi i hershëm i dobësive
- 41 senatorë nga shkollat e mesme trajnohen mbi higijenën kibernetike
- Universitetet në Qendër të Programit të Ri për Zhvillimin e Talenteve në Sigurinë Kibernetike
- Trajnim pesëditor nga SEI për rritjen e kapaciteteve institucionale në vlerësimin e riskut kibernetik

Ballkani Perëndimor në fokus: forcimi i kapaciteteve për identifikimin dhe kundërveprimin ndaj kërcënimeve hibride



Konferenca dhe Ushtrimi i Simulimit mbi Kërcënimet Hibride në Ballkanin Perëndimor i organizuar në Tiranë nga Hybrid CoE në bashkëpunim me AKSK, solli në vëmendje dinamikën e kërcënimeve hibride që prekin rajonin. Ekspertë nga institucionet euro-atlantike, përfaqësues qeveritarë, akademikë dhe profesionistë të sigurisë diskutuan mbi taktikat e përdorura nga aktorët keqdashës, sfidat e rajonit dhe masat e koordinuara për t'ju përgjigjur tyre në mënyrë efektive.

Drejtori i Përgjithshëm i AKSK-së, Igli Tafa, theksoi se kërcënimet hibride kërkojnë një qasje të integruar që bashkon analizën, teknologjinë, ndërgjegjësimin dhe bashkëpunimin rajonal. Ai nënvizoi se rritja e kapaciteteve kombëtare dhe rajonale, ndarja e informacionit dhe ngritja e mekanizmave të reagimit të shpejtë janë thelbësore për të garantuar sigurinë dhe rezistencën strategjike të rajonit përballë veprimtarive destabilizuese.



Nga reagimi te parandalimi: qasja e re kombëtare për menaxhimin e rrezikut kibernetik

AKSK prezantoi qasjen e unifikuar kombëtare për menaxhimin e rrezikut kibernetik gjatë një aktiviteti me pjesëmarrjen e institucioneve publike, operatorëve të shërbimeve thelbësore dhe infrastrukturave kritike të informacionit. Gjatë sesionit u shpjegua metodologjia e standardizuar që udhëzon institucionet në identifikimin, vlerësimin dhe trajtimin e rreziqeve, duke krijuar një bazë të përbashkët për vendimmarrje dhe planifikim strategjik.

Drejtori i Përgjithshëm i AKSK-së, Igli Tafa, theksoi se transformimi i kulturës institucionale nga reagimi ndaj incidenteve drejt parandalimit proaktiv është thelbësor për një mjedis kibernetik të qëndrueshëm. Ai nënvizoi se zbatimi i metodologjisë së re dhe rritja e aftësive praktike të institucioneve janë elemente kyçe për të përballuar me efikasitet kërcënimet në rritje dhe për të garantuar sigurinë digjitale në nivel kombëtar.



Adresa : Rruga "Papa Gjon Pali
II", Nr. 3, Kati I Tiranë



www.aks.gov.al




[@aks.gov.al](https://www.instagram.com/aks.gov.al)



+355 422 21 039

NËNTOR 2025



AKSK vendos fokusin te testimi inteligjent dhe vlerësimi i hershëm i dobësive

Në vijim të serisë së takimeve me operatorët e infrastrukturave kritike dhe të rëndësishme të informacionit, Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike zhvilloi sesionin e tretë teknik me temë “Monitorimi dhe Simulimi Proaktiv”, me pjesëmarrjen e rreth 250 përfaqësuesve. Gjatë hapjes, Drejtori i Përgjithshëm i AKSK-së, z. Igli Tafa, theksoi se siguria kibernetike duhet të bazohet në parashikim dhe parandalim, duke nënvizuar rolin e dijes, trajnimit dhe ekspertizës profesionale në rritjen e kapaciteteve institucionale.

Në aktivitet u prezantua platforma kombëtare për testime të depërtueshmërisë, e cila shfrytëzon inteligjencën artificiale për identifikimin dhe analizimin e dobësive në sistemet digjitale, si dhe u diskutua roli i Red Team dhe qasjet e reja të bashkëpunimit ndërsektorial. Nisma është pjesë e programit “AKSK ProActive 2026”, që synon forcimin e qasjes parandaluese dhe ndërtimin e një ekosistemi të qëndrueshëm kombëtar të sigurisë kibernetike.

41 senatorë nga shkollat e mesme trajnohen mbi higjienën kibernetike

Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike organizoi një sesion trajnimi me 41 senatorë nga shkollat e mesme, me fokus në higjienën kibernetike dhe ndërtimin e praktikave të sigurta në mjedisin digjital. Gjatë aktivitetit u prezantuan rreziqet kryesore që prekin të rinjtë në internet, mënyrat e identifikimit të mashtrimeve online dhe masat mbrojtëse për sigurinë personale dhe të dhënave.

Trajnimi synoi rritjen e ndërgjegjësimit dhe forcimin e rolit të të rinjve si promotorë të sigurisë digjitale në komunitetet e tyre shkollore. AKSK nënvizoi rëndësinë e edukimit të hershëm dhe përfshirjes aktive të brezit të ri në ndërtimin e një kulture të qëndrueshme kibernetike, duke theksuar se investimi në njohuritë e tyre përbën një shtyllë të rëndësishme të sigurisë kombëtare.



Universitetet në Qendër të Programit të Ri për Zhvillimin e Talenteve në Sigurinë Kibernetike

Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike zhvilloi një takim me rektorë, përfaqësues të universiteteve dhe zëvendësministren e Arsimit, ku CRDF Global prezantoi një projekt katërvjeçar të mbështetur nga Departamenti Amerikan i Shtetit, i orientuar drejt rritjes së kapaciteteve teknike dhe akademike në fushën e sigurisë kibernetike. Projekti synon përafrimin e programeve universitare me kërkesat reale të tregut të punës si dhe forcimin e rolit të institucioneve të arsimit të lartë në zhvillimin e kapaciteteve kombëtare digjitale.

Programi përfshin një paketë ndërhyrjesh strategjike, si trajnimi i trajnuesve, zhvillimi i moduleve praktike dhe rishikimi i politikave të arsimit të lartë, me synimin që universitetet të ndërtojnë struktura funksionale që në të ardhmen mund të ofrojnë trajnime dhe shërbime të tipit SOC. Takimi shërbeu për të përcaktuar hapat e parë të zbatimit, duke vendosur bazat për një bashkëpunim të qëndrueshëm mes AKSK, universiteteve dhe partnerëve ndërkombëtarë në ndërtimin e një ekosistemi të talenteve në sigurinë kibernetike.

Trajnim pesëditor nga SEI për rritjen e kapaciteteve institucionale në vlerësimin e riskut kibernetik

Software Engineering Institute (SEI) i Carnegie Mellon University, në bashkëpunim me Departamentin Amerikan të Shtetit dhe AKSK, zhvilloi një trajnim pesëditor të dedikuar për stafin e AKSK, AKSHI dhe institucionet e përfshira në procesin kombëtar të vlerësimit të riskut. Programi u fokusua në aftësimin e pjesëmarrësve për të analizuar dhe përdorur rezultatet e vlerësimeve të sigurisë kibernetike, me qëllim identifikimin e risqeve kritike dhe zbatimin e kontrolleve të nevojshme për forcimin e mbrojtjes institucionale.

Në hapjen e aktivitetit, Drejtori i Përgjithshëm i AKSK-së, z. Igli Tafa, vlerësoi mbështetjen e ndërsjellë të Departamentit të Shtetit dhe ekspertizën e SEI, duke theksuar rolin e tyre në përmirësimin e kapaciteteve teknike dhe promovimin e një qasjeje proaktive ndaj menaxhimit të riskut. Gjatë programit, pjesëmarrësit punuan me module të specializuara mbi qasjet e vlerësimit, përdorimin e standardeve, interpretimin e rezultateve dhe përcaktimin e përgjegjësiave institucionale, duke përfunduar me rekomandime konkrete për forcimin e proceseve të sigurisë.



Adresa : Rruga "Papa Gjon Pali
II", Nr. 3, Kati I Tiranë



www.aks.gov.al



[@aks.gov.al](https://www.instagram.com/aks.gov.al)



+355 422 21 039